

**GIJYKATA E QARKUT NE PRIZREN**, tre gjyqtar te kolegjit te shkalles se dyte, me anëtar tjerë, gjyqtar ndërkombëtar te EULEX-it Vladimir Kaney, gjyqtar civil si kryetar i trupit gjykues, gjyqtar Klaus Huener, gjyqtar i EULEX-it dhe gjyqtar civil Fikri Shishko, si anëtar te kolegjit, duke pasur parasysh ankesen, te parashtruar nga [REDACTED] te përfaqësuar nga [REDACTED] nga fshati Shpenadi, Prizren kundër aktvendimit te datës 05.03.2009 per hudhje poshte te aktvendimit te gjykatës komunale te Prizrenit ne rastin C. No. 41/09 me te paditurin [REDACTED] nga Prizreni lëshon si ne vijim:

**AKTVENDIM**

Aktivendimi i gjykatës se shkalles se pare ne rastin C. No. 41/09 te datës 05.03.2009 përmjet kësaj eshte ANULLUAR dhe rasti eshte kthyer mbrapa ne gjykatën komunale te Prizrenit per ne procedure et rregullt.

Aktivendimi i shkalles se dyte eshte i plotfuqishëm dhe nuk lejohet ankesa ndaj tij.

**ARSYETIM**

Rasti eshte parashtruar ne Gjykata e shkalles se pare ne Prizren me 02.02.2009 me numrin te referencës nr. 41/2009. Paditësi [REDACTED] ka deklaruar se ai eshte pronar i patundshmerise ne Kosove, shtëpi familjare te ndërtuar ne parcelën ndërtimore nr. [REDACTED], parcela kadastrale [REDACTED] ne [REDACTED] ne Prizren ne baze te padise i paditurit [REDACTED] kishte zaptuar ne mënyre te paligjshëm pronën ne fshat 'mbas mbarimit te luftës'. Ankesa e paraqitur përmban propozimin per aktgjykimin e cila konfirmon pronesin e paditësit dhe depjon te paditurin nga lokalet.

Se bashku me padinë eshte edhe nje dëshmi e shkruar ne mbështetje te pronesin se supozuar.

Me aktivendim te datës 19.02.2009 gjyqtari i gjykatës komunale ka kërkuar nga paditësi qe te dërgoje dëshmit shtese per te dëshmuar pronesin ne afat prej 3 ditëve, formalisht duke e justifikuar kete urdhër ne nenin 102.1 dhe 102.3 te LPK-se, gjyqtari e vlerësoj dëshminë si te pa njatfueshme.

Me 25.02.2009 përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka parashtruar kopjen e re te dëshmisë se njëjte me parashtrësën duke cekur se kjo eshte e tere qka ai posedonte.

Duke marrur parasysh parashtrësën gjyqtari i gjykatës se shkalles se pare me 05.03.2009 ka cekur ne aktivendim per hudhje poshte te padise. Aktivendimi eshte i justifikuar ne mënyre te ligjshëm ne baze te nenit 102.3 te LPK-se dhe arsyetimin se paditësi nuk in eshte përmbajtur me urdhëresën te gjykatës. Rrijedhimisht duket qe eshte dërguar ne koha dhe rasti me numër nr. 205/09 eshte regjistruar ne gjykatën e qarkut te Prizrenit.

Ankesa duhet te konsiderohet si e pranueshme. Eshte dërguar brenda afatit ligjor dhe i plotësion te gjitha parakushte te detyrueshme. Pranueshmeria nuk eshte shprehur.



ankuesi nuk ka dërguar ankесë me 19 Shkurt, urdhri i gjykatës i cili ishte i bazuar ne nenin 102.1 te LPK-se. Se pari dhe me rendësi se vepra nen nenin 102.1 eshte nje ' urdhër ' apo ' udhëzim ' , e cila nuk eshte lende e ankesës. Ne vazhdim e drejta e palës ndergjygesore per ankese ndaj aktvendimit qe e mund te prish plotfuqishemirin nuk janë ndërprer per te mos u ankuar kundër veprimere te me hershem te gjykatës.

Kolegji i Gjykatës se shkalles se dyte e konsideron aktvendimin e hedhur poshte te datës 05.03.2009 si te paligshëm dhe te jo te drejte. Aktvendimi i ankimuar paraqet konfuzion te madhe ndërmjet padise e cila eshte e pranueshme dhe padise se bazuar. Ne rastin ne fjale paditësi i plotëson te gjitha kërkesat formale per dorëzimin e nje padie te pranueshme sipas nenin 99.2 te LPK-se. Ai po ashtu i ka perfshir numërt te njafueshëm te provave per te cilen referohet dhe kërkon per dëshmi. Gjykata e shkalles se pare gabimisht e ka zbatuar nenin 102 te ligjit duke dhënë urdhrin per dëshmi te tjera. Ne kete faze fillestare te kësaj procedure gjykata nuk mund te peshoje deshmirt dhe te merr vendimin nëse padia eshte aprovuar. Marija e vendimeve zakonisht vjen mbas shqyrtimit kryesor, por edhe si nje përjashtim te peshës se dëshmisë nuk mund te merr pjese para se padia eshte dërguar tek pala tjetër ndergjygesore.


Duke e hedhur poshtë ne mënyrë te pa ligshëm padinë gjykata e shkalles se pare e privon paditësin nga shqyrtimi kryesor dhe kjo llogaritet si mohim i drejtësisë.

Prandaj, aktvendimi i ankimuar duhet te anulohet dhe rasti te kthehet ne gjykatën e shkalles se pare per vazhdim te procedurës.

Ne baze te arsyeve te cekura me larte kolegji i gjykatës se shkalles se dyte mori aktvendimin e tyre.

### GJYKATA E QARKUT NE PRIZREN

Ac. Nr. 205/09, me 12.08.2009



Kryetari i trupit gjykses

Z. Kadimir Kanev